



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Dhjetor 2020 | Nr: 34

VENDIM

PËR MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TË LËNDËS SË POSAÇME PËR TIMBRIMIN E ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafi 1, shkronja “ë”, nenin 105, paragrafi 1, shkronja “dh”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N:

Referuar nenit 19, paragrafi 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për miratimin e specifikimeve teknike të materialeve zgjedhore që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin t’i dërgojë Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për qendrat e votimit nën juridiksion.

Referuar nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,



Data: 23 Dhjetor 2020
Nr. 2582

Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në KZAZ materialet zgjedhore të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi. Në paragrafin 1, shkronja “ë”, të dispozitës sipërcituar parashikohet dërgimi i materialit zgjedhor “lëndë të posaçme për timbrimin e zgjedhësit”.

Kodi Zgjedhor, në Pjesën IX, Kreu II “Procedurat gjatë votimit”, neni 105 paragrafi 1 shkronja “dh” përcakton se “zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së, me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në proceset zgjedhore pararendëse ka miratuar specifikimet e lëndës së posaçme, në përputhje me karakteristikat që përcakton Kodi Zgjedhor, e cila ka përmbushur plotësisht qëllimin për të identifikuar zgjedhësit që kanë ushtruar të drejtën e votës. Lënda e posaçme e miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe e përdorur në procese zgjedhore, tip “marker”, me përmbajtje 20% nitrat argjendi, ka patur efekt të menjëhershëm, ka qënë e dukshme me shikim të lirë, rezistente për më shumë se 24 orë, e pacënueshme nga çdo veprim i jashtëm, dhe njëherazi e padëmshme për organizmin.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafi 1, shkronja “ë”, nenin 105, paragrafi 1, shkronja “dh”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Të miratojë specifikimet e lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, si më poshtë:
 - a) e dukshme me shikim të lirë;
 - b) nuk hiqet për jo më pak se 24 orë nga koha e timbrimit;
 - c) me efekt të menjëhershëm;
 - ç) ngjyrë e zezë;
 - d) përmbajtje nitrat argjendi 20%;
 - dh) e padëmshme për organizmin;
 - e) e pa cënueshme nga agjentë atmosferikë.



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data 13 Dhjetor 2020
Nr. 2582

Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për
Kuvend të datës 25 Prill 2021